



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: _____

Nr: ____

Ora: __:__

PROJEKTVENDIM
PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 351, DATË 29.03.2025, TË KOMISIONERIT
SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE “PËR CAKTIMIN E VENDEVE TE
NUMERIMIT TE VOTAVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ
2025”

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 93, pika 1 dhe nenit 94, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Vendet e Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, janë përcaktuar me vendimin nr. 351, datë 29 mars 2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”, sipas lidhjes 3 të tij. Bazuar në listën e dërguar nga Prefekti i qarkut Tiranë, për VNV e KZAZ-së nr 35, është caktuar palestra e shkollës “Hasan Prishtina”.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr.35 me shkresën, nr. 02 prot, datë 08.04.2025, kërkon rishikimin e vendimit nr.351, datë 29.03.2025, për ndryshimin e Vendit të Numërimit të Votave, nga palestra e shkollës “Hasan Prishtina”, në palestrën e shkollës “Bajram Curri”.

- Plotëson tërësisht kriteret ligjore dhe infrastrukturore, përfshirë sipërfaqen e kërkuar prej jo më pak se 200 m² për KZAZ-të deri në 80 Qendra Votimi;
- Ndodhet brenda kufijve territorialë të ZAZ-së, nr.35;
- Disponon një dhomë ndihmëse ngjitur me sallën e palestrës e cila është planifikuar të përshtatet për vendosjen e pajisjeve PEI dhe dhomave të fshehta të votimit, duke garantuar kështu një organizim më efikas të procesit zgjedhor në tërësi;

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 93 pika 1, nenin 94, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Data: DD MM VVVV Nr: 00 00
Ora: HH:MM



Për një ndryshim të vendimit nr.351, datë 29.03.2025 ,
“Për caktimin e vendeve të numrit të votave për Zgjedhjet
për Kuvend të datës 11 Maj 2025”

V E N D O S:

1. Në lidhjen 3, bashkëlidhur vendimit nr.351, datë 29 mars 2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Përcaktimin e Vendit të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025, bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:
 - a) Në Qarkun Tiranë, në KZAZ-në nr.35, objekti për VNV, palestra e shkollës “Hasan Prishtina”, zëvendësohet me palestrën e shkollës “Bajram Curri”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: DD MM VVVV Nr: 00 00
Ora: HH:MM



Për një ndryshim të vendimit nr.351, datë 29.03.2025 ,
“Për caktimin e vendeve të numrit të votave për Zgjedhjet
për Kuvend të datës 11 Maj 2025”